



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTYT
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. U. Nr. 01 Br. 8840
Nr. i faq. 2 Data: 15/04
Br. str. Datum: 2025
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 14.04.2025

Në bazë të nenit 12 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në përputhje me nenin 3 paragrafi 3.10 dhe neni 38 paragrafi 38.2 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës si dhe neni 11 i Rregullores Sh.01.Nr.13678 e datës 14.04.2023 të Komunës së Kamenicës për Procedurën e Ndarjes së Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve të tjera, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:27.03.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e propozimeve për ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve të tjera

- 1. Formohet Komisioni i veçantë për shqyrtimin e propozimeve për ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve të tjera, në përbërje:**
 - 1.1.** Hasan Krasniqi, përfaqësues nga Kuvendi
 - 1.2.** Magbule Kastrati, përfaqësuese nga Kuvendi
 - 1.3.** Arlinda Rrudhani, përfaqësuese nga Kuvendi
 - 1.4.** Valdete Berisha, anëtare nga ekzekutivi
 - 1.5.** Lavdim Klaiqi, përfaqësues nga OJQ
 - 1.6.** Edon Dërmaku, Anëtar Rezervë nga ekzekutivi
- 2.** Detyra e Komisionit, të formuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, është të shqyrtojë propozimet dhe të marrë vendime në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Me rekomandim, aprovim ose refuzim, ai i drejtohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendimmarrje, duke siguruar dokumentacionin dhe procesverbalet përkatëse.
- 3.** Mandati i Komisionit është dy (2) vjeçar dhe përfshin shqyrtimin, vlerësimin dhe rekomandimin e propozimeve për ndarjen e titujve, të nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve të tjera. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni angazhohet në mbledhjen dhe analizimin e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe në vlerësimin e kandidatëve të propozuar bazuar në kriteret e përcaktuara në Rregulloren Komunale Sh.01.Nr.13678, datë 14.04.2023,

për ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve të tjera.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Kamenicës.
5. Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit, dhe do të publikohet në web faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Anëtarëve të Komisionit MAPL-së, QSHQ dhe arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Lindon Kastrati